



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni Pranveror
Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja Nr. 46
Prishtinë, më 12.10.2010, ora 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Sanije Aliaj, Rexhep Hoti, Numan Balić, Xhevdet Neziraj, Dragiša Mirić, Enis Kervan, Hetem Arifi Sadik Idriz dhe Hafize Hajdini dhe Mursel Haljilji.

Munguan: Petar Miletić, Zylfi Merxha, dhe Müfera Şinik.

Në mbledhje prezantuan: përfaqësuesja nga OSB-ja Lejla Selimi, përfaqësuesi nga KDI dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit.

Nga Stafi Mbështetës: Natasa Prica-Tisma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Sanije Aliaj, Zëvendëskryetarja e parë e Komisionit

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve nga data 3.09.2010, 14.09.2010 dhe 28.09.2010,
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin Policor - me raport të Komisionit funksional - Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente,
4. Shqyrtimi i planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Integrimin Evropian për vitin 2010- sfidat e mbetura,
5. Shqyrtimi i propozim planit të monitorimit të zbatimit të ligjit për Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Kryesuesja-konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës

Kryesuesja – para miratimit të rendit të ditës fjalën ia dha **Numan Balic**.

Numan Balic- theksoi se si pikë e rendit të ditës në Seancë Plenare nuk është dashur të shqyrtohet Projektligji për Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave sepse Komisioni në mbledhjen e kaluar nuk është akorduar të nxjerrë Raport dhe se Projektligji është miratuar në Kuvend pa vullnetin e komuniteteve, andaj mendon se përgjegjësia për këtë çështje i bie zëvendëskryesueses së komisionit.

Kryesuesja – në fjalën e saj tha se Kryesia në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare, përcakton rendin e ditës për mbledhje në Kuvend andaj ne duhet ti respektojmë procedurat në fjalë. Ajo tha se si udhëheqëse e komisionit çdo herë ka respektuar diskutimet dhe vendimet e marra në komision dhe se asnjëherë nuk ka shkel procedurat ligjore dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Nga anëtarët e komisionit kërkoj që për çështje vendimmarrëse Komisioni të jetë konstruktivë dhe në Kuvend të dal me propozime konkrete.

Sa i përket shqyrtimit të Projektligjit për Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave, ajo tha se në Seancë Plenare ka dhanë opinionin e saj në bazë të vendimeve të miratuara në komision .

Enis Kervan- tha se në Seancë Plenare ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me Projektligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe të Banesave i cili ka një rëndësie të veçantë për komunitetin shumicë dhe jo shumicë dhe se ka diskutuar për amendamentin e propozuar nga grupi i KDTP dhe më pas konstatoi se i njëjti nuk u miratua në Kuvend.

Ai njëkohësisht falënderoi zëvendës kryesuesen e komisionit në paraqitjen e saj në Seancë Plenare, me theks të veçantë se Komisioni nuk ka pregaditë Raport me rekomandime në Projektligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe të Banesave

Ai paraqiti opinionet e veta se në ueb faqe të Kuvendit të Kosovës nuk janë publikuar çështjet të mbledhjeve të fundit të komisionit dhe se qytetarët nuk janë informata rreth qëndrimit të komisionit për Projektligj, andaj propozoi që të mos përsëriten gjërat e njëjta.

Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve nga data 3.09.2010, 14.09.2010 dhe 28.09.2010,

Procesverbalet e mbledhjeve të datës **3.09.2010, 14.09.2010 dhe 28.09.2010** u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin Policor - me raport të Komisionit funksional - Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri, me amendamente.

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, me shumicë votash, nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I. . Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin për Inspektoratin Policor dhe ka konstatuar se projektligji me amendamente nuk cenon dhe nuk prekin të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i rekomandon Kuvendit të miratojë projektligjin me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Integrimin Evropian për vitin 2010- sfidat e mbetura.

Kryesuesja, theksoi se për përmbushje të sfidave në raportin e Planit të Veprimit të Komisionit për Integritet Evropian, dalin përgjegjësit që komisionet brenda këtij viti kalendarik të procedojnë 28 projektligje për miratim në Seancë Plenare.

Shtroi çështjen se në takimin e rregullt me kryeparlamentarin e Kuvendit, në temën për përmbushjen e sfidave të raportit të Planit të Veprimit, ka ngrit çështjen e Projektligjit për dhënien e Dekorativave dhe se ka kërkuar që projektligji të procedohet më tej, ndërsa informata është se ky projektligj do të kthehet Qeverisë për plotësim, me qëllim të sigurimit të një qasje adekuate për komunitetet.

Gjithashtu, si sfida për përmbushjen e planit të veprimit ka mbet Projektligji për shitblerjen e banesave ku ekziston e drejta banesore dhe se është obliguar kryetari i komisionit funksional, Naser Rugova të marr hapa konkret dhe të ftohen ekspertë ndërkombëtar, ekspertë vendor dhe anëtarët e nëngrupit të komisionit tonë, me qëllim të ofrimit të ndihmës gjatë hartimit të propozimeve të reja për ndryshimin dhe plotësimin e projektligjit, i cili Ligj do të garanton pronat e paluajtshme të qytetarëve.

Numan Balić – në fjalinë e tij diskutoi lidhur me sfidat e mbetura lidhur me planin e veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Integrimin Evropian për vitin 2010, ka kërkuar që të merren parasysh edhe njohurit nga komisioni jon, siç është rasti me Projektligjin për Regjistrimin e Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe të Banesave që nuk janë marr në konsideratë amendamentet e komuniteteve. Vërejtje tjetër është se ka shkelje të Ligjit për Vetëqeverisje lokale dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Në fund theksoi se nuk do të paraqitem me raport të përgjithësuar por kërkoj që komisioni të dalë me raport të detajuar me të dhënat lidhur me mungesën e dispozitave ligjore, moszbatimi i disa ligjeve të miratuara në Kuvend, moszbatimi i Kushtetutës lidhur me stemën e komunës së Prizrenit dhe për çështjet tjera lidhur me mosrespektimin e të drejtave dhe Interesave të komuniteteve.

Saniya Aliaj- lidhur me çështjen e ngritur nga ana e parafolësit, tha se komisioni nuk mund të dalë në Kuvend me fakte të përgjithësuara apo të pa konkretizuara. Më pas kërkoj nga Numan Balić, si udhëheqës i nënkomisionit dhe si detyrë kryesore ka pas të vizitoi Institucionet publike dhe ato lokale dhe para Komisioni të paraqet argumente konkrete sa po zbatohen ligjet dhe a ka progres në integrimin e komuniteteve në Institucionet publike dhe në komuna.

Rexhep Hoti – në fjalinë e tij tha se nuk pajtohet me diskutimet e zot, Balić, më pas theksoi se Ligji për përdorim të gjuhëve garanton të drejtat dhe Interesat e komuniteteve, gjithashtu tha se përkrahje të plotë ju ofron Komisioni Evropian që komunitetet të integrohen në shoqëri.

Xhevdet Neziraj- në fjalën e tij tha se në bazë të planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Integrimin Evropian, komisioni duhet të bazohet me vërejtje konkrete.

Vërejtja e tij konkrete është se në faqen 18 përmenden të gjitha komunitetet, në faqe 20 përmenden komunitetet REA që do të thotë ka diskriminim sepse komunitetet shkruhen ashtu siç e ndiejnë veten. Andaj kërkoj që këto çështje duhet të definohen në bazë të Ligjit për Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës dhe në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kryesuesja, konstatoi se Komisioni për të Drejta dhe Interesa të Komuniteteve dhe Kthim në bazë të detyrave të komisionit të përcaktuara me propozimin e Planit të veprimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me Projektligjin për ndarjen e dekorativave të Kryetarit të Republikës së Kosovës dhe Projektligjin për shitblerjen e banesave ku ekziston e drejta banesore, do të nxjerrë Raport dhe do t'ia përcjellë Komisionit për Integritet Evropian.

6. Shqyrtimi i propozim planit të monitorimit të zbatimit të ligjit për Mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës.

Kryesuesja, me kërkesë të anëtarëve të komisionit kjo pikë e rendit të ditës është shtyre për një periudhë me qëllim që të ofrohen të dhëna më efektive dhe më kualitative.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetarja e parë Komisionit

Sanije Aliaj